



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e martë, datë 19.05.2026, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Desada	METAJ	Zëvendëskryetar
Aurela	BICJA	Anëtar
Besian	ZOGAJ	Anëtar
Gjergji	HAMITI	Anëtar
Jetmir	HALILAJ	Anëtar
Joana	ALLUSHI	Anëtar

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Rinovimin e licencës së shoqërisë “Media Living” sh.p.k., për subjektin audio privat lokal “Radio Living”, për një periudhë 7 (shtatë) vjeçare. **(Vendim nr. 46, datë 19.05.2026)**
2. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “MTSC” sh.p.k., duke kaluar të drejtat dhe detyrimet e licencës së shërbimit të programit audio privat lokal “City Radio Albania”, nga shoqëria “Triangle Media Group” sh.p.k. tek shoqëria “MTSC” sh.p.k., me afat vlefshmërie deri në datën 02.09.2029. T’i heqë shoqërisë “Triangle Media Group” sh.p.k., licencën për shërbimin e programit audio privat lokal “City Radio Albania”. **(Vendim nr. 47, datë 19.05.2026)**

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 19 Maj 2026